

# NJOFTIM I KPK MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT Z. ARTAN HAJREDINAJ.



Komisioni i  
Pavarur i  
Kualifikimit

Kreu Rreth Nesh Legjislacion Denonco! Programi i transparencës Njoftime Vendime Statistika



## NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT Z. ARTAN HAJREDINAJ



19/03/2024

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 12.3.2024, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj, bazuar në ligjin nr. 84/2016, vendosi:

1. Konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Transferimin e çështjes penale me numër vendimi 12, datë 6.4.2020 dhe çështjes penale me numër vendimi 94/60, datë 28.3.2022, pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Vendimi, i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Valbona Sanxhaktari, znj. Firdes Shuli relatores dhe z. Olsi Komici anëtar, do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim me përjashtim të pikës 2, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 19.3.2024.

*Njoftimi i mësipërm është marrë në faqen zyrtare të KPK në linkun: <https://kpk.al/njoftim-mbi-seancen-e-shpalljes-se-vendimit-per-subjektin-e-rivleresimit-z-artan-hajredinaj/35/>*